



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.199/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmnnani dhe Hasan Shala anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**PRANOHET** si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënim i më gjybë, në shumë prej 2,000.00 (*dymijë*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcenim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 12.10.2017 nga organizata BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se kandidati Nehat Gashi për Anëtar të Komunës së Prizrenit, nga radhët e subjektit politik PDK, përmes faqes së rrjetit social Faceebok ka përdorur një fëmijë nën moshën 18 vjeçar, për të zhvilluar fushatë zgjedhore. Me këtë rast, parashtruesi i ankesës ka theksuar se është shkelur neni 5.2 i Rregullës Zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) të datës 13.10.2017, thekson se pretendimet ankimore të BIRN-it dhe Internews Kosova janë të pa bazuara dhe nuk përbëjnë shkelje zgjedhore, sepse fotografia e prezantuar nga kandidati në fjalë është nxjerrë nga faqja e tij e rrjetit social Faceebok dhe në ambientet e shtëpisë së tij. Më tutje ka shtuar se, fëmija në foto është i tij personalisht dhe nisur nga ky fakt, konsideron se kjo nuk përbën shkelje zgjedhor, prandaj PZAP-it i ka kërkuar që ankesën ta refuzoj si të pa bazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoj shkresat lëndës konform dispozitës së nenit 117 paragrafi 2 i LZP-së, konstatoj se :

**Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtuesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka vërtetuar se Nehat Gashi, kandidat për Anëtar të Komunës së Prizrenit, nga radhët e subjektit politik PDK, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes, nga fakti se, kandidati në fjalë ka bërë fushatë zgjedhore me fëmijë nën moshën 18 vjeq, veprime këto të sanksionuara me dispozitën e nenit 5.2 i Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së.

Paneli, ka konstatuar se nga prova e prezantuar në shkresa të lëndës rezulton se subjekti politik PDK ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, pasi që vërehet qartë se fëmija i moshës nën 18 vjeqar mbanë në duar një vizitkartë me përbajtje të materialit të fushatës zgjedhore.

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.
- Personat të cilët nuk i kanë mbushur 18 vjet nuk mund të përfshihen në Ditën e Zgjedhjeve

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik PDK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtë janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre për shkeljen e supozuar, pretendimet në ankesë nga ana e panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë. Ndërsa, veprimet që nuk i kanë ndërmarrë për të bërë përmirësimin e shkeljes nga subjekti politik PDK, për Panelin janë vlerësuar negativisht dhe me ndikim në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi se dënim i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.199/2017 më datën 16.10.2017



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së